

Vendim nr. 187 datë 19.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 19.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: IRINI BUA, MANTHO BUA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-476, datë 19.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Irini Bua dhe Mantho Bua kanë paraqitur kallëzim për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal (*KP*) ndaj një deputeti, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë për Krime të Rënda, më 29.12.2017, ka regjistruar procedimin penal nr. 364 të vitit 2017. Ata kanë pretenduar se deputeti i kallëzuar ka përfituar një sipërfaqe toke prej 11.000 m² e cila është pronë e familjes së kërkuesit Mantho Bua. Pas përfundimit të hetimeve prokuroria ka paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes penale, pasi nuk ka konstatuar konsumimin e elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së ose të ndonjë vepre tjetër penale.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 113, datë 21.12.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e çështjes penale nr. 364 të vitit 2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 37, datë 12.02.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, vendim ndaj të cilit kërkuesit kanë paraqitur rekurs.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-476, datë 19.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 24.06.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesve

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi objekt kundërshtimi u ka cenuar:

6.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi, megjithëse ata kanë paraqitur rregullisht kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë, kjo e fundit nuk e ka marrë në konsideratë duke vijuar gjykimin në mungesë. Në këtë mënyrë gjykata u ka hequr mundësinë për të shprehur qëndrimin e tyre lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal dhe për të paraqitur prova të tjera. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim nenin 329/b, pika 2, të KPP-së, pasi ajo

duhej të shtynte seancën në një datë tjetër. Edhe gjykata e apelit edhe Gjykata e Lartë nuk i kanë marrë në konsideratë këto shkelje procedurale.

6.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat kanë arsyetuar se transaksionet e bëra nga deputeti i kallëzuar nuk janë fiktive, leja e zhvillimit dhe ndërtimit është dhënë përpara se ai të blinte pronën, se ai nuk ka pasur ndikim në dhënien e lejes dhe se prona është e lirë dhe pa masë sigurimi. Të gjitha këto argumente nuk qëndrojnë, pasi prona ka qenë nën masën e sigurimit dhe ajo nuk ishte e lirë. Prokuroria nuk ka bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes, nuk ka kryer ekspertim topografik dhe nuk ka marrë të dhëna nga kallëzuesit. Po kështu, ajo nuk ka hetuar aktivitetin dhe burimet e deputetit për kryerjen e transaksioneve me pronën. Të tria gjykatat kanë zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin penal material, duke favorizuar deputetin e kallëzuar prej kërkuesve, si dhe kanë anashkaluar faktin se hetimet për veprën penale nuk kanë qenë të plota dhe shteruese.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesve

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

8. Kolegji vëren se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individuale, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike efektive. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin në shqyrtim, Kolegji evidenton se kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit që ka përmbyllur procesin penal të nisur për kallëzimin penal të tyre. Për rrjedhojë, ata e kanë plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

11. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 19.03.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 24.06.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesit në objektin e ankimit kushtetues individual kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, ndërsa në përmbajtjen e tij kanë kundërshtuar edhe vendimet e gjykatave më të ulëta të marra në procesin gjyqësor ku ata kanë qenë palë ndërgjyqëse. Kështu ata kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, si dhe standardit të arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur

13. Kërkuesit kanë pretenduar se megjithëse ata kanë paraqitur rregullisht kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë, kjo e fundit nuk e ka marrë në konsideratë duke vijuar gjykimin në mungesë. Në këtë mënyrë gjykata u ka hequr mundësinë për të shprehur qëndrimin e tyre lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal dhe për të paraqitur prova të tjera. Sipas kërkuesve, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim nenin 329/b, pika 2, të KPP-së, pasi ajo duhej të shtynte seancën në një datë tjetër. Edhe gjykata e apelit edhe Gjykata e Lartë nuk i kanë marrë në konsideratë këto shkelje procedurale.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se drejta për t'u dëgjuar është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra për komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr.43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji vëren se, referuar nenit 329/b, pika 2, të KPP-së, kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij shqyrtimi, rezulton se seanca paraprake për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit është planifikuar nga gjykata e shkallës së parë për t'u shqyrtuar në datën 07.12.2018. Pavarësisht se palët janë njoftuar dhe janë paraqitur rregullisht, seanca nuk është zhvilluar, ndërsa gjykata ka pranuar kërkesën e kërkuësve për t'iu dhënë mundësi të njihen me aktet dhe provat e prokurorit dhe për të mbajtur qëndrimin e tyre rreth kërkesës së tij. Për datën e seancës së radhës nuk del që palët të kenë paraqitur kontestime, por përpara asaj, në datën 14.12.2018, kërkuesi Mantho Bua ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shtyrjen e seancës së datës 21.12.2018, me argumentin se bashkëshortja e tij ishte larguar jashtë shtetit për arsye shëndetësore dhe se ai nuk mund të paraqitej personalisht pa shoqërimin e saj për arsye moshe. Në seancën e radhës kërkuësit nuk janë paraqitur, ndërsa gjykata ka shqyrtuar kërkesën e tyre për shtyrjen e saj, duke vendosur të mos e pranojë atë dhe të zhvillojë gjykimin pa praninë e tyre, në respektim të nenit 329/b, pika 2, të KPP-së. Sipas gjykatës, kërkuësit nuk kanë provuar ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për të justifikuar mungesën e tyre, ndërsa largimi jashtë shtetit i njërit prej tyre nuk ishte shkak i arsyeshëm për të justifikuar ligjërisht mungesën e tyre në seancë paraprake. Në vijim, pasi janë njohur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kërkuësit kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit duke ngritur pretendime qoftë për sa i përket zhvillimit të seancës paraprake pa praninë e tyre, ashtu edhe për themelin e çështjes, pra për

kërkesën e prokurorit dhe për vendimin e gjykatës për pranimin e saj. Po kështu, të njëjtat pretendime ata i kanë parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

16. Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesve për zhvillimin e seancës në mungesë të tyre është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt dhe në respektim të dispozitave ligjore për zhvillimin e kësaj seance (*shih faqen 22 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*). Në vijim, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt dhe në respektim të dispozitave ligjore, për zhvillimin e seancës gjyqësore (me këtë natyrë gjykimi) konform neneve 329 e vijues të KPP-së, për rrjedhojë e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkuesve (*shih paragrafët 17-18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

17. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë, kërkuesve u është dhënë mundësia dhe koha e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tyre procedurale, qoftë personalisht, ashtu edhe nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur nga vetë ata. Megjithatë, kërkuesit as nuk kanë zgjedhur një përfaqësues dhe as kanë shfrytëzuar të drejtën për të depozituar përpara gjykatës qëndrimin e tyre me shkrim rreth kërkesës së prokurorit. Pavarësisht kësaj, gjatë vijimit të procesit, përmes ankimit në gjykatën e apelit dhe rekursit në Gjykatën e Lartë, atyre u është dhënë mundësia dhe kanë arritur të parashtrorjnë këtë qëndrim, përfshirë edhe pretendimet në drejtim të vendimeve të gjykatave. Për rrjedhojë, procesi gjyqësor i zhvilluar nuk paraqet parregullsi në drejtim të pjesëmarrjes në gjykim dhe së drejtës për t'u mbrojtur. Po kështu, Kolegji evidenton se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë kthyer përgjigje pretendimit të kërkuesve në lidhje me zhvillimin e gjykimit në shkallën e parë pa praninë e tyre, duke argumentuar se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë për këtë aspekt të procesit është në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 329/b, pika 2, të KPP-së, për sa kohë ata nuk kanë arritur të parashtrorjnë shkaqe të arsyeshme për mungesën në seancën paraprake. Pra, ky aspekt i procesit i është nënshtruar kontrollit rishikues nga gjykatat më të larta, duke mos gjetur shkelje të të drejtave të tyre.

18. Për këto arsye, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

19. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat kanë arsyetuar se transaksionet e bëra nga deputeti i kallëzuar nuk janë fiktive, leja e zhvillimit dhe ndërtimit është dhënë përpara se ai të

blinte pronën, se ai nuk ka pasur ndikim në dhënien e lejes dhe se prona ishte e lirë dhe pa masë sigurimi. Sipas kërkuesve, të gjitha këto argumente nuk qëndrojnë, pasi prona ka qenë nën masën e sigurimit dhe ajo nuk ishte e lirë. Prokuroria nuk ka bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes, nuk ka kryer ekspertim topografik dhe nuk ka marrë të dhëna nga kallëzuesit. Po kështu, ajo nuk ka hetuar aktivitetin dhe burimet e deputetit për kryerjen e transaksioneve me pronën. Të tria gjykatat kanë zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin penal material, duke favorizuar deputetin e kallëzuar prej kërkuesve, si dhe kanë anashkaluar faktin se hetimet për veprën penale nuk kanë qenë të plota dhe shteruese.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Megjithatë, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadër të përmbushjes ose jo të standardeve kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, sikurse pretendojnë edhe kërkuesit në rastin konkret. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, për sa i përket kallëzimit të paraqitur nga kërkuesit, Kolegji vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit penal në ngarkim të të kallëzuarit me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 328/1, shkronja “b”, të KPP-së. Gjykata e shkallës së parë, në analizë të provave dhe fakteve të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, ka

vlerësuar se i kallëzuari është blerësi fundor i një sipërfaqeje toke për të cilën mes anëtarëve të familjes Bua ka një konflikt pronësie. Sipas gjykatës, në kohën e fitimit të pronësisë funksioni publik që ai ushtronte nuk kishte asnjë lidhje me pronën në fjalë dhe ai nuk rezulton të ketë pasur as ndonjë ndalim ligjor, për shkak të funksionit publik që kryente në këtë kohë, për të kryer veprime juridike në lidhje me këtë pronë. Po kështu, masa e pezullimit e vendosur me vendim gjyqësor i përket një sipërfaqeje tjetër toke dhe jo asaj të përfituar me kontratën e shkëmbimit nga deputeti i kallëzuar dhe se miratimi i lejes së zhvillimit të pronës nga Këshilli Kombëtar i Territorit është bërë në kohën kur pronarë të saj ishin persona të tjerë dhe jo shtetasi i kallëzuar. Në përfundim, kjo gjykatë ka vlerësuar se fitimi i pronësisë nga i kallëzuari nuk përbën përfitim të parregullt për të, për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar që lidhet me funksionin publik të tij dhe që nuk i takon në bazë të këtij funksioni dhe njëkohësisht këto nuk janë as veprime që bien në kundërshtim me ligjin e që përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga ana e tij në kohën e lidhjes së kontratës. Sipas gjykatës, veprimet e kryera nga shtetasi i kallëzuar nuk përmbajnë elementet e ndonjë veprë penale të parashikuar në KP ose në ndonjë ligj të veçantë, pra ato nuk parashikohen nga ligji si veprë penale. Gjykata ka vërejtur se ky konkluzion nuk paragjykon të drejtat e pronësisë dhe ato trashëgimore të kallëzuesve (kërkuesve) dhe nuk paragjykon as mënyrën e zgjidhjes të çdo lloj mosmarrëveshjeje civile për të drejtat e pronësisë dhe të trashëgimisë mes tyre dhe personave të tjerë të familjes Bua (*shih faqet 15-16 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*).

23. Në të njëjtën linjë arsyetimi është shprehur edhe gjykata e apelit, e cila ka evidentuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka analizuar në mënyrë të detajuar provat e mbledhura nga prokuroria, duke vlerësuar me të drejtë mungesën e elementeve të veprës penale, ka verifikuar nëse ekzistojnë shkaqet ligjore për pushimin e procedimit penal, ka analizuar drejt kërkesat e ekzistencës së një fakti penal (*shih faqet 19-22 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*).

24. Për rekursin e kërkuesve Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se pretendimet e tyre nuk u referohen shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas kësaj gjykate, kërkuesit ngrenë pretendime në lidhje me mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat më të ulëta, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji. Po kështu, ajo ka vlerësuar se gjykata e apelit ka trajtuar dhe i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të parashtruara në ankim. Fakti se qëndrimi/konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë dhe më pas edhe të gjykatës së apelit lidhur

me plotësinë e hetimeve dhe ligjshmërinë e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, nuk përputhen me pretendimet e ankuesve, nuk do të thotë se pretendimet e tyre nuk janë vlerësuar nga gjykata apo se vendimi i rekursuar nuk është i argumentuar (*shih paragrafët 13 - 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

25. Nga sa më lart, Kolegji vëren se vendimi i gjykatës së shkallës së parë tregon ecurinë e hetimit paraprak, objektin e tij dhe provat e grumbulluara nga prokurori në funksion të të provuarit ose jo të faktit penal. Po kështu, ai përmban një analizë të qëndrimit të prokurorit në lidhje me plotësinë e hetimeve paraprake, vlerësimin e të dhënave që rezultojnë nga provat e grumbulluara, duke treguar edhe arsyet për të cilat gjykata i ka vlerësuar si të plota hetimet dhe përfundimin për mosekzistencën e ndonjë fakti penal në veprimet ose mosveprimet e personit të kallëzuar. Së fundi, vendimi tregon edhe dispozitat ligjore në të cilat gjykata është bazuar për pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal. Të njëjtët elemente të arsytimit gjenden edhe në vendimin e gjykatës së apelit, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të kërkuësve, krahas të dhënave në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, tregon shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e gjykatës se nuk janë nga ato të parashikuar nga ligji ose janë haptazi të pabazuara, përfshirë edhe argumentet e saj përkatëse në këtë drejtim. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se vendimet gjyqësore kanë përmbushur standardet kushtetuese për arsytimin e vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.